



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 148/2020

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 97/2016 “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 43 pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

“e) përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton.”

Neni 2

Pas nenit 107 shtohet neni 107/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 107/1

Marrëdhëniet me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cenon ruajtjen e sekretit hetimor sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, numrin e personave nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel

ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë edhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u përgjigjen kërkesave të KQZ-së për informacion jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 17.12.2020